



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRI

Numri i lëndës: 2024:208060
Datë: 09.09.2024
Numri i dokumentit: 06138510

CPP.nr.59/2024

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRI, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, me gjyqtarin Leotrim Gashi, dhe bashkëpunëtorin profesional Besart Prishtina, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit M.G, kundër debitorit B.R duke vendosur sipas prapësimit të debitorit, të ushtruar kundër urdhrorit për përmbartim të Përmbartuesit privat Atip Mustafa në Vushtri, P.nr.973/24, të datës 07.06.2024, jashtë seancës, me datën 09.09.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si i pabazuar prapësimi i debitorit B.R, i ushtruar kundër urdhrorit për përmbartim të Përmbartuesit privat Atip Mustafa në Vushtri, P.nr.973/24, të datës 07.06.2024 dhe i njëjti urdhër mbetet në fuqi.

A r s y e t i m

Kreditori M.G, në bazë të dokumentit përmbartimor, Aktvendimit të Gjykatës Themelore Mitrovicë – Dega Vushtri - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.550/23, të datës 16.08.2023, i vërtetuar me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, AC.nr.6494/2023, të datës 02.04.2024, ka parashtruar propozim për përmbartim pranë Përmbartuesit privat Atip Mustafa në Vushtri, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet debitori B.R, që ashtu siç është urdhëruar me dokumentin përmbartimor (Aktvendimi i Gjykatës Themelore Mitrovicë – Dega Vushtri - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.550/23, të datës 16.08.2023) dispozitivin II

të tij, menjëherë t'a kthej gjendjen e mëparshme, duke larguar dheun nga parcela me numër..., që gjendet në si dhe kreditorit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës përbarimore.

Përbaruesit privat Atip Mustafa në Vushtrri, me urdhrin P.nr.973/24, të datës 07.06.2024 e ka lejuar përbarimin sipas propozimit të kreditorit.

Debitori, brenda afatit ligjor ka parashtruar prapësim kundër urdhrin për lejimin e përbarimit të përbaruesit privat. Sipas këtij prapësimi është theksuar *“Kundër vendimit P.nr.973/24, i datës 07.06.2024 i pakënaqur në afatin ligjor parashtroj prapësimin për shkak se dheu për të cilin bëhet fjalë është larguar nga vendi i ngjarjes dhe tani ska as qka të ekzekutohet siq ka kërkuar kreditori. Kërkoj që të refuzohet propozimi për përbarim të paraqitur nga ana e kreditorit”*.

Kreditori me datë 15.07.2024 ka parashtruar përgjigje në prapësim, duke i propozuar gjykatës që prapësimin e debitorit t'a refuzoj si të pabazuar me arsyetimin se debitori nuk e ka kthyer gjendjen e mëparshme në parcelën me numër 137-0 që gjendet në fshatin Bukosh, ZK Vushtrri, konkretisht nuk ka vepruar sipas urdhrin të gjykatës, të përcaktuar me aktvendimin e Gjykatës Themelore Mitrovicë – Dega Vushtrri, C.nr.550/23, i datës 16.08.2023.

Gjykata pas shqyrtimit të prapësimin të debitorit dhe përgjigjes në prapësim nga ana e kreditorit e në raport me provat në shkresat e lëndës, gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar, për faktin se nuk ekziston asnjë nga shkaqet e prapësimin sipas nenit 71 të LPP-së.

Sipas vlerësimit të gjykatës, dokumenti përbarimor, konkretisht aktvendimi i Gjykatës Themelore Mitrovicë – Dega Vushtrri, C.nr.550/23, i datës 16.08.2023, i plotfuqishëm me datën 02.04.2024 dhe i ekzekutueshëm me datën 06.05.2024, e i vërtetuar me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.6494/2023, të datës 02.04.2024, është dokument përbarimor sipas nenit 22, par. 1, nën par. 1.2 ku është përcaktuar se *“Dokumente përbaruese janë: vendimi përbarues i Gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësore përbaruese:”*, dhe nenit 23 par. 1 *“Sipas këtij ligji, vendim gjyqësor konsiderohet aktgjykimi, aktvendimi, si dhe vendimi tjetër i dhënë në procedurën gjyqësore...”*.

Tutje, gjykata vlerëson se aktvendimi në fjalë është i përbarueshëm konform nenit 24 par.1 ku është përcaktuar *“Vendimi gjyqësor me të cilin është urdhëruar përmbushja e kredisë për ndonjë dhënie apo bërje, është i përbarueshëm po që se ka marrë formë të prerë, si dhe po qe se ka*

skaduar afati për përmbushje vullnetare.” pasi ky aktvendim është bërë i plotfuqishëm me datën 02.04.2024, ndërsa është bërë i ekzekutueshëm me datën 06.05.2024. Kjo vërtetohet përmes vulave të vendosura në aktvendim.

Po ashtu, sipas vlerësimit të gjykatës, dokumenti përbarimor i kësaj çështje është i përshtatshëm për përbarim konform nenit 27 par. 1 të LPP-së, ku parashihet që *“Dokumenti përbarimor është i përshtatshëm për përbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*, kjo ngase në dokumenti përbarimor përmban të gjitha elementet e kërkuara nga dispozita e mësipërme.

Lidhur me pretendimin e debitorit se i njëjti ka përmbushur urdhrin e gjykatës duke larguar dheun nga vendi i ngjarjes dhe së më nuk ka as çka të ekzekutohet, për gjykatën një pretendim i tillë është tërësisht i pabazuar.

Prandaj gjykata duke u bazuar në nenin 69 par 4, të LPP-së, sipas të cilit thuhet se *“Baza për prapësim duhet të mbështetet me prova të duhura. Provat për prapësimin duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet”*, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi sepse debitori nuk ka ofruar as edhe një provë të vetme se i njëjti e ka larguar dheun nga parcela që ka qenë objekt shqyrtimi në procedurën kontestimore, për çka është vendosur me dokumentin përbarimor.

Për me tepër, në përgjigje në prapësim kreditori ka deklaruar se pretendimi i debitorit se e ka larguar dheun është i pavërtetë kurse fakti se a është përmbushur detyrimi i debitorit sipas dokumentit përbarimor apo nuk është përmbushur, do të vërtetohet në procedurën e ekzekutimit të urdhrin përbarimor nga ana e Përbaruesit Privat.

Andaj, gjykata, nga arsyet e cekura më lart, bazuar në nenin 73 të Ligjit për Procedurën Përbarimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL**

2024:208060, CPP.nr.59/2024, me datë 09.09.2024

G j y q t a r i

Leotrim Gashi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditësh, pas ditës së pranimi të të njëjtit, përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.